



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA GJIROKASTËR

KËSHILLI

P/ VENDIM

Nr. ___ datë __. __. 2024

PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR PËRDORIMI E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK- NDIHMËN EKONOMIKE DERI NE 6% PËR MUAJIN MAJ 01-30.04.2024.

Në bazë të Ligjit nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr.597, date 04.09.2019 për “Për Përcaktimin e Procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike, përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, Këshilli i Bashkisë Gjirocastër, me propozim të kryetarit të bashkisë Gjirocastër;

VENDOSI :

1. Të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin Maj 2024, 8 (tetë), individë/ familje me fond **25,919 lekë**.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtorja e Shërbimeve Sociale dhe Shëndetësore, (Sektori i Ndhmës Ekonomike dhe Paaftësisë), si dhe Drejtorja e Financës.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR I KËSHILLIT
MERITA IRASAJ**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI

P/VENDIM

Nr. ___ date __. __. 2024

**PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË
BASHKISË PËR FAMILJET QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE
PËR MUAJIN MAJ 01-31.05.2024.**

Në bazë të Ligjit nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr.597 datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike, përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, vendimit Nr 85 datë 10.02.2021, si dhe bazuar në Udhëzimi nr.4 datë 17.02.2017 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, pika 7, Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Ligjit 68/2017 “Mbi Financat e Vetëqeverisjes Vendore” VKB nr. 113 datë, 14.12.2023 për “Për Miratimin Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026 dhe Buxhetit Vjetor 2024” është miratuar fond “Ndhma Ekonomike” me fond limit 1.800.000 lekë/ vit, Këshilli i Bashkisë Gjirokastër.

VENDOSI :

1. Të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin **Maj 2024, 38 individë/ familje me fond 125,313 lekë.**
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Shëndetësore, (Sektori i Ndhmës Ekonomike dhe Shërbimeve Shoqërore), si dhe Drejtoria e Financës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT
Merita ISARAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA GJIROKASTËR

KESHILLI BASHKISË

Nr _____ Prot _____

Gjirokastër më ___/___/2024

P/ VENDIM

Nr. _____, datë / / 2024

Për

“Miratimin e kërkesës së Bashkisë Gjirokastër, së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor për akordimin e ndihmës financiare për familjen e z. Çezar Gjoksi, banesa e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit, nga buxheti i bashkisë për vitin 2024, fondi i emergjencave civile,

Baza Ligjore

Ligji 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligji për prefektin e Qarkut, Ligji Nr.45/2019, datë 18.7.2019 “Për Mbrojtjen Civile, VKM nr.329, datë 16.5.2012, “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprime njerëzore”

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Gjirokastër për mbështetjen financiare të shtetasit Çezar Gjoksi për dëmtimin e banesës së tij nga zjarri .
 2. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga bashkia Gjirokastër .
 3. Ti akordoje familjes së shtetasit Çezar Gjoksi , ndihmë financiare në vlerën prej **200.000(dyqind mije)** lekë nga buxheti i bashkisë Gjirokastër , fondi i emergjencave civile i destinuar dhe i miratuar nga Këshilli i bashkisë për vitin 2024 me kod. **VO91AAC dhe me kod programi AD115**
 4. Ndihma financiare për familjen e shtetasit Çezar Gjoksi , përcaktohet sipas kriterëve të VKM-së Nr. 329, datë 16.5.2012.
 6. Ndihma financiare që do të akordohet do të përdoret për ti ardhur në ndihmë familjes së shtetasit Çlirim Gjoksi, banesa e të cilit është dëmtuar nga zjarri.
- Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër.

Kryetari i Këshillit Bashkisë

Merita Isaraj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË**

P/VENDIM

NR. ____, datë ____ : ____ :2024

“PËR DHËNIEN E TITULLIT “QYTETAR NDERI” PËR Z. ROLAND KARALLI (pas vdekjes)”

Në kuadër të vlerësimit të figurës së Z. Roland Karalli, si dhe në zbatim të ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Neni 54, pika (m) si dhe Ligjit Nr.112/2013 "Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit", V.K.M Nr. 861, datë 10/12/2014 "Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimorë për dhënien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit", Këshilli i Bashkisë i mbledhur në datën ____ . ____ 2024, pasi mori në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, për dhënie tituli "Qytetar Nderi" për Z. Roland Karalli , si dhe mbështetur në relacionin e Komisionit Vendor për Dhënien e Titujve të Nderit,

VENDOSI:

1.Të miratojë dhënien e titullit “Qytetar Nderi” për Z. Roland Karalli (pas vdekjes) me motivacionin:

“Për kontribut të shquar në mjekësi, për përkushtimin, profesionalizmin dhe humanizmin e treguar gjatë gjithë karrierës së tij në shërbim të qytetarëve të Qarkut Gjirokastrë, për vlerat si kirurg dhe qytetar i denjë”.

2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Trashëgimisë, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

3.Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, neni 55 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” .

SEKRETAR I KËSHILLIT

Etleva Yzo

KRYETAR I KËSHILLIT

Merita ISARAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA GJIROKASTER
KESHILLI BASHKIAK

P/VENDIM

Nr. ____, date __. __. 2024

PËR

**"MIRATIMIN E PLANIT TË MASAVE PËR PARANDALIMIN DHE PËRBALLIMIN
E SITUATAVE TE ZJARREVE GJATË SEZONIT TE VERËS NË SIPËRFAQET
PYJE- KULLOTA NË BASHKINË GJIROKASTËR"**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, te Kushtetutës , të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja" b", nenit 29, pika 2, nenit 54, shkronja "k", nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr.139/2015, "Për vetqeverisjen vendore", te ndryshuar ,Ligjit nr.152/2015, "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", Ligjin nr.45/2019, "Për mbrojtjen civile", Ligjit nr.45/2016, "Per vullnetarizimin", me propozimin e Kryetarit te Bashkisë , Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

- 1.Të miratojë " Planin e Masave" bashkëlidhur këtij vendimi.
- 2.Ngarkohet Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi për zbatimin e këtij vendimi.
- 3.Ky vendim hyn ne fuqi sipas përcaktimeve te pikës 6, te nenit 55, te Ligjit nr. 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore " të ndryshuar.

KRYETAR

Merita ISARAJ

SEKRETAR I KËSHILLIT

Etleva Yzo